



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Mbledhja plenare e Kuvendit
P-147
Prishtinë, më 12 dhjetor 2013

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 12 DHE 13 DHJETOR 2013**

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, ndërsa i ndihmoi nënkryetari i Kuvendit, Xhavit Haliti.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Bekim Haxhiu, Naser Osmani, Glauk Konjufca, Nijazi Idriizi, Emilija Rexhepi, Sasha Gjokiq, Valbona Dibra, Haki Demolli, Visar Ymeri, Kymete Bajraktari, Halit Krasniqi, Salih Morina dhe zëvendëskryeministrja Edita Tahiri, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Teuta Haxhiu parashtrroi pyetje për ministrin Fehmi Mujota, në lidhje me kohën e realizimit të projektit për ndërtimin e urës që lidh fshatrat e Lugut të Baranit dhe Lugut të Leshanit.

Ministri Fehmi Mujota iu përgjigj pyetjes së deputetes Teuta Haxhiu.

Deputeti Visar Ymeri parashtrroi pyetje për ministrin Hajredin Kuçi, në lidhje me një rast të zgjidhur nga Gjykata Themelore në Besianë dhe me ngecjen e procedurës së përmbarimit. Ministri Hajredin Kuçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Muhamet Mustafa parashtroi pyetje për ministrin Ramë Buja, në lidhje me nivelin e buxhetit për universitetet e reja publike të Pejës, Mitrovicës, Gjilanit dhe Gjakovës.
Ministri Ramë Buja nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Muhamet Mustafa parashtroi pyetje për ministrin Fehmi Mujota, në lidhje me atë se sa është norma e kthimit të investimeve nga projekti i autostradës Prishtinë-Shkup. Ministri Fehmi Mujota iu përgjigj pyetjes së deputetit Muhamet Mustafa.

Deputetja Time Kadrijaj parashtroi pyetje për ministrin Agim Çeku, në lidhje me atë se deri ku është arritur në punën e Komisionit qeveritar për verifikimin e dëshmorëve, të invalidëve dhe të veteranëve të luftës.
Ministri Agim Çeku nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Time Kadrijaj parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani, në lidhje me atë se konkursi i shpallur për drejtorë të klinikave të QKUK-së a është në përputhje me ligjet në fuqi?
Ministri Ferid Agani nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Alma Lama parashtroi pyetje për ministrin Besim Beqaj, në lidhje me interesin bankar për marrjen e huasë 16 milionëshe nga Arabia Saudite, për financimin e rrugës Prishtinë-Mitrovicë.
Ministri Besim Beqaj iu përgjigj pyetjes së deputetes Alma Lama.

Deputetja Alma Lama parashtroi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi, në lidhje me atë se çfarë kushtëzimesh ka bërë Qeveria e Kosovës ndaj Serbisë, për përmirësimin e gjendjes së shqiptarëve në Luginën e Preshevës, si dhe pse nuk është hapur zyra në Prishtinë dhe Gjilan deri më tani?
Kryeministri Hashim Thaçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Visar Ymeri parashtroi pyetje për ministrin Fehmi Mujota, në lidhje me atë se a ka Ministria që ai drejton raport të hollësishëm për shpenzimet e bëra nga Buxheti i Kosovës për ndërtimin e autostradës Vermicë-Merdare?
Ministri Fehmi Mujota iu përgjigj pyetjes së deputetit Visar Ymeri.

Deputeti Halit Krasniqi parashtroi pyetje për zv/kryeministrin Slllobodan Petroviq, në lidhje me atë se a do të ketë tolerime që ndonjë kryetar komune i zgjedhur në zgjedhjet lokale 2013, të mos i respektojë detyrimet ligjore në rastin e aktit të betimit dhe gjatë ushtrimit të detyrës së kryetarit?
Zv/kryeministri Slllobodan Petroviq nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Halit Krasniqi parashtroi pyetje për ministrin Fehmi Mujota, në lidhje me atë se a është e arsyeshme të vazhdohet gjatësia e të gjitha kycjeve dhe vendosja e rrethojave mbrojtëse në pjesën e autostradës nga Gjergjica deri në Prishtinë?
Ministri Fehmi Mujota iu përgjigj pyetjes së deputetit Halit Krasniqi.

* * *

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për investimet e huaja,
7. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për prokurimin publik në Republikën e Kosovës,
8. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ndërmarrjet publike,
9. Zgjedhja e katër anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,
10. Zgjedhja e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media,
11. Propozimi i Grupit Parlamentar të PDK-së për zëvendësimin e një anëtarë në Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

* * *

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës

Kryesuesi Xhavit Haliti e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

Zëvendëskryeministri Bujar Bukoshi tha se ky projektligj ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e nenit 12, paragrafi 6 të ligjit bazik që ka të bëjë me përbërjen e Këshillit Konsultativ për Komunitete.

Ai më pas ftoi deputetët për miratimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Jasmina Zhivković, në emër të Komisionit Funkcional për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim si dhe në emër të GP SLS; Elmi Reçica - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Lirije Kajtazi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Glauk Konjufca, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes

“Vetëvendosje”, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Sasha Gjokiq në emër të Grupit Parlamentar ZB, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në vazhdim, kryesuesi dha sqarime procedurale lidhur me procedurën e votimit për këtë projektligj, ku kërkohet minimumi i 61 votave “për” nga deputetët e Kuvendit, prej tyre 13 vota “për” nga deputetët e komuniteteve pakicë.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

Rezultati i votimit ishte:

Për ----- 35,
Kundër -----32,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi nuk miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

Ministri Besim Beqaj tha se duke marrë parasysh analizat e bëra, legjislacionin aktual në fushën e auditimit dhe të menaxhimit të financave publike, mund të vërehet që shkalla e pavarësisë së Auditorit të Përgjithshëm nuk është në nivel me standardet ndërkombëtare.

Ai më pas tha se ky projektligj rregullon organizimin, veprimtarinë dhe kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

Në fund ai ftoi deputetët për miratimin në parim të Projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Ali Sadriu, në emër të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, si dhe në emër të GP të LDK-së, Valbona Dibra, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Afrim Hoti, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Bali Muharremaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe deputeti Haki Demolli, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

Rezultati i votimit ishte:

Për ----- 68,
Kundër -----2,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës.

Raportin me rekomandime në emër të Komisionit Funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale e paraqiti deputetja Time Kadrijaj, diskutimi i plotë i së cilës është dhënë në transkript.

Kryetari hodhi në votim amendamentet e propozuara në këtë projektligj.

Kuvendi miratoi amendamentet nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 dhe 15.

Kuvendi nuk miratoi amendamentin nr. 7.

Pastaj, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 69,
Kundër ----- 6,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për investimet e huaja

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për investimet e huaja.

Raportin me rekomandime në emër të Komisionit Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e paraqiti deputeti Zenun Pajaziti, diskutimi i plotë i të cilit është dhënë në transkript.

Kryetari hodhi në votim amendamentet e propozuara në këtë projektligj.

Kuvendi i miratoi amendamentet nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30 dhe 31.

Pastaj, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 57,
Kundër ----- 7,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për investimet e huaja.

7. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për prokurimin publik në Republikën e Kosovës

Deputetja Safete Hadërgjonaj, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, theksoi se ky komision ka monitoruar zbatimin e Ligjit për prokurimin publik në Republikën e Kosovës dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Më tej ajo u fokusua në elaborimin e tërësishëm të këtij raporti dhe rekomandimeve që ka paraqitur Komisioni FunkSIONAL, për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji.

Në fund, ajo kërkoi miratimin e këtij raporti.

Diskutimi i deputetes Safete Hadërgjonaj është dhënë i plotë në transkript.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për prokurimin publik në Republikën e Kosovës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Safete Hadërgjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Hykmete Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Albana Fetoshi, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Sevdije Lama, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Sasha Milosavljeviq, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Goran Marinković, në emër të Grupit Parlamentar ZB, si dhe Myzeje Selmani, Zenun Pajaziti, Salih Morina, Amir Ahmeti dhe Vjollca Krasniqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari hodhi në votim raportin me rekomandime të Komisionit për Buxhet dhe Financa për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

Rezultati i votimit ishte:

Për ----- 66,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti me rekomandime i Komisionit për Buxhet dhe Financa për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për prokurimin publik në Republikën e Kosovës.

8. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ndërmarrjet publike

Deputeti Zenun Pajaziti, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, theksoi se ky komision ka monitoruar zbatimin e Ligjit për ndërmarrjet publike dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Më tej ai u fokusua në elaborimin e tërësishëm të këtij raporti dhe rekomandimeve që ka paraqitur Komisioni FunkSIONAL për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji. Në fund, ai kërkoi miratimin e këtij raporti.

Diskutimi i deputetit Zenun Pajaziti është dhënë i plotë në transkript.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ndërmarrjet publike.

Në emër të Qeverisë së Kosovës, diskutoi ministri i Zhvillimit Ekonomik, Fadil Ismaili, diskutimi i të cilit është dhënë i plotë në transkript.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Shaip Muja, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Lutfi Zharku, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Ramiz Kelmendi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Goran Marinković, në emër të Grupit Parlamentar ZB, si dhe Hykmete Bajrami, Teuta Sahatqija, Halit Krasniqi dhe Zenun Pajaziti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi hodhi në votim raportin me rekomandime të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ndërmarrjet publike.

Rezultati i votimit ishte:

Për----- 57,
Kundër----- 4,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti me rekomandime i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ndërmarrjet publike.

9. Zgjedhja e katër anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Deputeti Visar Ymeri, kryetar i GP të Lëvizjes “Vetëvendosje”, propozoi që pika 9 dhe pika **10 - Zgjedhja e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media**, të shqyrtohen bashkërisht për shkak të natyrës së njëjtë të procedimit.

Ai propozoi që Komisioni votues, i cili do të propozohet më vonë, për këto dy pika të jetë i njëjtë.

Propozuesi e hodhi në votim mocionin e deputetit Visar Ymeri që pika 9 dhe 10 të procedohen përnjëherë.

Më tej, kryetari sqaroi se për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë, kërkohet krijimi i një Komisioni votues nga përbërja e deputetëve, me mbështetje të zyrtarëve të administratës dhe ftoi përfaqësuesit e grupeve parlamentare, që të propozojnë nga një anëtar për Komisionin votues.

Grupet parlamentare propozuan këta anëtarë:

1. GP i PDK - Halit Krasniqi,
2. GP i LDK - Salih Morina,
3. GP i “Vetëvendosje” - Albana Gashi,
4. GP i AAK - Time Kadrijaj,
5. GP Koalicioni Kosova e Re - Ukë Rugova,
6. GP SLS - Mursel Halili,
7. GP “6+” - Rasim Demiri dhe
8. GP ‘ZB’ - Biserka Kostiq,

Kuvendi miratoi emërimin e anëtarëve në Komisionin votues.

Në lidhje me pikën - **Zgjedhja e katër anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**, kryesuesi i Komisionit ad hoc, Ramë Vataj, i njoftoi deputetët se Komisioni ad-hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka shqyrtuar nominimet e kandidatëve për anëtarë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Ai tha se kandidatët e propozuar nga komuniteti shumicë shqiptar janë: Shkëmb Manaj, Hajzer Salihu, Lulzim Aliaj, Besnike Mehmeti, Ismet Mecinaj dhe Fatmir Hoxha.

Ai më tej tha se kandidatët e propozuar nga komuniteti jo shumicë janë: Suada Korenica – Goriça dhe Gjylnaz Novoberdali – Gola.

Ndërsa lidhur me pikën - **Zgjedhja e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media**, kryesuesja e Komisionit ad-hoc, Xhevahire Izmaku, i informoi deputetët se Komisioni ad-hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media, ka shqyrtuar nominimet e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media dhe Kuvendit i ka paraqitur rekomandimin për miratim.

Ajo tha se kandidatët e propozuar janë: Adnan Merovci, Ardian Bajraktari, Alban Zeneli dhe Mentor Borovci.

Në vazhdim deputetët u ftuan një nga një për të votuar.

Pas numërimit të fletëvotimeve, në emër të Komisionit votues, raportin e paraqiti Halit Krasniqi.

Ai konstatoi se në votim morën pjesë 89 deputetë, ndërsa të pavlefshme janë 5 fletëvotime.

Rezultati i votimit për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga komuniteti shumicë shqiptar, ishte si në vijim:

Shkëmb Manaj, 59 vota,
Hajzer Salihu, 40 vota,
Lulzim Aliaj, 34 vota,
Besnike Mehmeti, 25 vota,
Ismet Mecinaj, 23 vota dhe
Fatmir Hoxha, 28 vota.

Rezultati i votimit për anëtarë të **Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil** të Kosovës, nga komuniteti joshumicë, ishte si në vijim:

Suada Korenica-Goriça, ka fituar 8 vota
Gjylnaze Novobërdali-Gola, ka fituar 31 vota.

Kryesuesi i Komisionit votues konstatoi se në rundin e parë të votimit anëtar i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës zgjidhet Shkëmb Manaj, ndërsa rundi i dytë i votimit zhvillohet për kandidatët: Hajzer Salihu, Lulzim Aliaj, Besnike Mehmeti dhe Fatmir Hoxha.

Ai tha se rundi i dytë i votimit duhet zhvillohet edhe për kandidatët nga komuniteti jo shumicë, ngase në listën e rundit të parë kishte pasur paqartësi teknike.

Ai kërkoi që Kuvendi të deklarohet për këtë propozim.

Kuvendi e miratoi propozimin e kryesuesit që në rundin e dytë të procedohet edhe me votimin për kandidatët nga radha e komuniteteve jo shumicë.

* * *

Në vazhdim, kryesuesi i Komisionit votues paraqiti para deputetëve rezultatet e votimit për zgjedhjen e dy anëtarëve të **Komisionit të Pavarur për Media**.

Ai konstatoi se në votim morën pjesë 89 deputetë, ndërsa të pavlefshme ishin 5 fletëvotime.

Rezultati i votimit për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media, ishte si në vijim:

Adnan Merovci, 42 vota,
Ardian Bajraktari, 40 vota,
Alban Zeneli, 22 vota dhe
Mentor Borovci, 43 vota.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Kuvendi nuk e miratoi rekomandimin e Komisionit ad hoc të datës 2.12.2013, për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media.
2. Komisioni i Pavarur për Media duhet të nxjerrë shpallje publike për zgjedhjen e dy anëtarëve nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar, në pajtim me nenin 11.2 të Ligjit për KPM-në.

* * *

Rundi II

Pas zhvillimit të procedurave të votimit dhe numërimit të fletëvotimeve, kryesuesi i Komisionit votues, paraqiti para Kuvendit rezultatet e votimit në raundin e dytë, si në vijim.

Ai konstatoi se në votim morën pjesë 64 deputetë, ndërsa të pavlefshme nuk kishte asnjë fletëvotim.

Rezultati i votimit për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga komuniteti shumicë shqiptar, ishte si në vijim:

Hajzer Salihu, 38 vota,
Lulzim Aliaj, 25 vota,
Besnike Mehmeti, 19 vota dhe
Fatmir Hoxha, 11 vota.

Rezultati i votimit për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga komuniteti joshumicë, ishte si në vijim:

Suada Korenica-Goriça, 10 vota dhe
Gjylnaze Novobërdali-Gola, 47 vota.

Kryesuesi i Komisionit votues konstatoi se në raundin e dytë të votimit anëtar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga komuniteti shumicë shqiptar, zgjidhet Hajzer Salihu, ndërsa raundi i tretë i votimit zhvillohet për kandidatët: Lulzim Aliaj dhe Besnike Mehmeti.

Ndërsa në këtë raund anëtare e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga komuniteti shumicë shqiptar, zgjidhet Gjylnaze Novobërdali-Gola.

Në vazhdim, kryesuesi në mungesë të kuorumit për të proceduar me raundin e tretë të votimit për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i mbylli punimet e seancës së sotme në orën 19:45 minuta, për të vazhduar nesër në orën 10:00.

E premte, 13 dhjetor 2013

Vazhdimi i mbledhjes plenare, të filluar më 12 dhjetor

Seancën e drejtoi Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit.

Ai procedoi me pikat si në vijim:

9. Votimi në raundin e tretë për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nga komuniteti shumicë shqiptar

Kryesuesi tha se në mbledhjen e sotme vazhdohet me votimin në raundin e tretë për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nga komuniteti shumicë shqiptar.

Ai ftoi Komisionin votues të emëruar në mbledhjen plenare të djeshme që të fillojë me procedimin e votimit, ndërsa më pas deputetët u ftuan të votojnë sipas listës.

Rundi III

Pas procedurës së votimit dhe numërimit të fletëvotimeve, kryesuesi i Komisionit votues, paraqiti para Kuvendit rezultatet e votimit në raundin e tretë, si në vijim.

Ai konstatoi se në votim morën pjesë 82 deputetë, të pavlefshme ishin 12 fletëvotime.

Rezultati i votimit për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga komuniteti shumicë shqiptar, ishte si në vijim:

Lulzim Aliaj, 45 vota dhe
Besnike Mehmeti, 25 vota.

Kryesuesi i Komisionit votues konstatoi se në raundin e tretë të votimit, anëtar i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga komuniteti shumicë shqiptar, zgjidhet Lulzim Aliaj.

Kryesuesi i seancës konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

I. Anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar, zgjidhen:

1. Shkëmb Manaj,
2. Hajzer Salihu dhe
3. Lulzim Aliaj.

II. Anëtar i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nga komuniteti joshumicë zgjedhet znj. Gjylinaz Novoberdali-Gola.

III. Mandati i anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është pesë (5) vjet.

11. Propozimi i Grupit Parlamentar të PDK-së për zëvendësimin e një anëtari në Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Kryesuesi i njoftoi deputetët për propozimin e Grupit Parlamentar të PDK-së për zëvendësimin e një anëtari në Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

Meqë nga Grupi Parlamentar i PDK-së ishin proceduar dy propozime për zëvendësimin e një anëtari në Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, kryesuesi kërkoi nga GP i PDK-së që të konsultohen se me cilin propozim të procedohet për zëvendësimin e anëtarit në Komisionin e lartshënuar.

Kryesuesi i mbylli punimet e seancës plenare në orën 11:20.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale